

A ka sanksione ndaj zyrtarëve për refuzim (mosdhënie) të informacionit të kërkuar?

Po, ligji parashikon përgjegjësi direkte ndaj zyrtarëve që refuzojnë të japin informacionin e kërkuar. Komisioneri është institucioni përgjegjës për trajtimin dhe verifikimin e ankesave për shkelje të së drejtës së informimit.

Në rast të verifikimit nga Komisioneri të shkeljes të së drejtës për informim, aplikohen gjopa të drejtpërdrejta ndaj titullarit të institucionit, koordinatorit të së drejtës së informimit apo për çdo nëpunës përgjegjës për mosdhënie informacioni.

50 mijë deri në 100 mijë lekë

variojnë gjokat në rast të:

- moshartimit të Programit institucional të transparencës;
- mosrshikimit të tij brenda afateve të caktuara ligjore;
- mosndjekjes së procedurave për rishikimin e këtij Programi.

50 mijë - 300 mijë

variojnë gjokat në rastet kur kërkesa për informacion:

- Refuzohet;
- Nuk plotësohet brenda afatit të caktuar ligjor;
- Nuk dërgohet pranë autoritetit publik që e disponon atë brenda afatit të caktuar ligjor.

25 mijë - 100 mijë

variojnë gjokat në rast të:

Moskrijimit, mosmbajtjes, mospublikimit apo mospërditësimit të Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

150 mijë - 300 mijë

variojnë gjokat në rastet kur:

- dëmton ose shkatërron dokumentet zyrtare, me qëllim shmangien e së drejtës për informim;
- pengon ushtrimin e të drejtës për informim përmes moszbardhjes së dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me rregullat në fuqi.



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

— E DREJTA PËR — INFORMIM

Procedura e ankimit dhe sanksionet në rast
të refuzimit të kërkesës për informim



Çdo qytetar ka të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë arsyet e kërimit të informacionit.

Njohja me informacionin publik bëhet përmes dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit kërkuar.

Çfarë konsiderohet informacion publik?

Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar nga institucionet publike në çfarëdo lloj forme e formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht se kush ka qenë autoriteti që e ka përgatitur atë.

Si dhe ku mund të ankohemi në rast të refuzimit të kërkesës për informacion?

Në rast se ju vlerësoni se ju janë shkelur të drejtat për të marrë informacion (nuk ju është kthyer përgjigje ose përgjigja e kthyer nuk është e plotë) keni të drejtë të ankoheni në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim Komisioneri).

Ankimi administrativ pranë Komisionerit bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

- ju nuk keni marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
- ka kaluar afati ligjor për dhënien e informacionit të kërkuar.

Cila është procedura e ankimit?

Ankesa mund të dërgohet me e-mail në adresën **info@idp.al**, dorazi ose me postë në adresën: **Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë**, nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al* dhe portalit *e-albania.al*.

Komisioneri verifikon faktet dhe bazën ligjore ku është mbështetur ankesa juaj. Komisioneri mund t'ju kërkojë juve (në cilësinë e ankuesit) dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin shpjegime të tjera me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër.

Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri mund të zhvillojë një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e të dy palëve.



Çfarë vendos Komisioneri në lidhje me ankesën tuaj për refuzim të kërkesës për informim?

Komisioneri pas vlerësimit të ankesës tuaj vendos:

- pranimin e saj dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme brenda një afati të caktuar. Në rast se autoriteti nuk jep sërish informacion, Komisioneri ka të drejtë të përcaktojë përgjegjësinë direkte dhe gjobën për titullarin e autoritetit publik, koordinatorin e të drejtës së informimit, apo çdo nëpunës të autoritetit, i cili ka penguar plotësimin e kërkesës tuaj.
- mospranimin e ankesës kur:
 - ka kaluar afati i caktuar ligjor për paraqitjen e ankesës;
 - ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
 - nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit.
- rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht.